



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:187438

Datë: 28.10.2024

Numri i dokumentit: 06362667

C.nr.790/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtorin profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit T.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati D.M nga Prizreni, ndaj të paditurës S me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e objektit të kontestit 1,000.00 euro, jashtë seancës, më datën 28.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit T.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, ndaj të paditurës S me seli në Prishtinë, në çështjen juridike kontestimore, C.nr.790/2023.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi T.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tij avokatit D.M nga Prizreni, më datën 01.09.2023, ka parashtruar padinë ndaj të paditurës S me seli në Prishtinë, për shkak të objektit të kontestit të kompensimit të dëmit, vlera e objektit të kontestit në shumë prej 1.000,00 euro.

I autorizuari i paditësit, me parashtrësën e datës 02.10.2024 e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë, me arsyetim se në këtë fazë nuk kanë interes për vazhdimin e procedurës, pasi që me të paditurën janë në negociata për të provuar arritjen e marrëveshjes jashtëgjyqësore.

Prandaj, meqenëse e paditura nuk ka parashtruar përgjigje në padi, kjo gjykatë vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore që padia e paditësit të konstatohet e tërhequr. Kështu, në nenin 261.1 të LPK-së parashihet që *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.”*

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t’i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së pasi që secila palë paraprakisht vet i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 261.1, 261.3 dhe 261.4 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2023:187438
Datë: 28.10.2024
Numri i dokumentit: 06362667

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.790/2023, më datën 28.10.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.